

Drejtor, Drejtoria e AL-CSIRT, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Aktit Normativ të miratuar nga Këshilli i Ministrave, Nr.15, Datë 13.10.2022, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9880, Datë 25.02.2008, “Për Nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, VKM-së Nr.141, datë 22.02.2017 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Drejtor, Drejtoria e AL-CSIRT, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Propozon politikat për garantimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar dhe kontribon në përfshirjen e tyre në Strategjinë kombëtare të Sigurisë.
2. Drejton procesin e monitorimit dhe garanton që trajtimi i incidenteve të bëhet në kohë dhe në zbatim të legjislacionit dhe raporton për vendimarrje tek titullari i institucionit.
3. Drejton dhe koordinon veprimatrinë e drejtorisë në kuadër të respektimit të afateve dhe të procedurave dhe analizon të dhënat më qëllim evidentimin e treguesve statistikor të stë cilat ndikojnë treguesit Global të Sigurisë kibernetike (GCI).
4. Koordinon punën, planifikon, ekzekuton, vlerëson dhe monitoron të gjitha detyrat e përcaktuara në kuadër të CSIRT-it Kombëtar.
5. Kryen kërkime të vazhdueshme mbi zhvillimet në fushën e sigurisë kibernetike dhe rekomandon upgrade sigurie në rastin e konstatimeve të vulnerabiliteteve..

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor me 120 kredite dhe 2 vite akademike/ e barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë”, në Shkenca Kompjuterike/Informatike; Inxhinieri Telekomunikacioni / Teknologji Informacioni. Edhe diploma “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë.

Përvoja: Të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune në profesion nga të cilat jo më pak se 3 vjet në fushën e sigurisë kibernetike.

Njohuri shumë të mira të:

- Legjislacionit për sigurinë kibernetike;
- Akteve nënligjore për listën e Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të informacionit;
- Gjuhës angleze.

Aftësi për të:

- Përcaktuar objektiva, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
- Planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi;
- Organizuar burimet, komunikuar dhe prezantuar;
- Analizuar dhe përshtatur me metodat dhe procedurat e reja;
- Menaxhuar situatat incidentesh dhe për të analizuar informacionet, risqet dhe ndjekur masat e kundërmasat për mbrojtjen.

Të kete aftesi shume te mira në menaxhim/auditim/ IT security ose eksperiencë akademike qe lidhet me fushen e sigurisë kibernetike

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (II-b)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidatiduhet të paraqesë brenda datës 23.01.2023 në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave (njesimin e diplomave nëse janë marrë jashtë vendit)
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.